

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË AKSIONARE

“AutoPjesë Partner” SH.A.

Sot, më datë 20 /03 /2018, Aksioneri i vetëm i shoqërisë:

Sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të datës 03/03/2018, të shoqërisë “AutoPjesë Partner” shpk nga Kosova kanë vendosur themelimin e shoqërisë “AutoPjesë Partner” SH.A. në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërisë Tregtare” të ndryshuar.

KAPITULLI I FORMA LIGJORE, EMËRTIMI, SELIA E SHOQËRISË

NENI 1

Forma juridike

Në mbështetje të vullnetit të aksionerit të vetëm të shoqërisë të shprehur në Vendimin e Aksionerëve të datës 03/03/2018 si dhe në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, forma juridike e Shoqërisë Tregtare “AutoPjesë Partner” SH.A, është ajo e shoqërisë aksionere me ofertë private, e cila do të funksionojë sipas dispozitave të këtij statuti.

NENI 2


Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë që përdoret dhe në qarkullimin juridiko - civil është Shoqëria Tregtare “AutoPjesë Partner” SH.A..

NENI 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë

- a. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është pakufizim dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar .
- b. Aksionari i vetëm i Shoqërisë sipas një vendimi të posaçëm mund të vendosë kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë.



NENI 4

Objekti i veprimitarise

- a. Shoqëria, ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri aksionare në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti.
- b. Objekti i veprimitarise se shoqërisë është : "Import-eksport i pjeseve te kembimit dhe aksesoreve te automjeteve, vajrave lubrifikante per automjete. Tregtim me shumice dhe pakice te pjeseve te kembimit dhe aksesoreve te automjeteve te gjitha llojeve, tregtim me shumice dhe pakice te vajrave lubrifikante per automjete, ne dyqane te specializuara. Shitia me shumicë dhe pakicë e Paisjeve dhe veglave (mjeteve) te punës për Autoservise".
- c. Veprimitaria e shoqërisë kryhet sipas lejeve dhe licencave përkatëse.
- d. Shoqeria AutoPjese Partner sha, pervec sa me siper, do ushtroje veprimitarine e saj nen licencen e dhene nepermjet nje marreveshje specifike periodike nga dhe me shoqerine AutoPjese Partner shpk ne Kosove. Shoqeria AutoPjese Partner sha, detyrohet te paguje shoqerine AutoPjese Partner shpk, Kosove, nje vlere financiare vjetore e cila do te percaktohet nga shoqerite ne marreveshjet specifike mes tyre.

NENI 5

Selia dhe Zyrat e Përfaqësimit

- a. Selia qendrore e Shoqërisë do të jetë në adresën : Fshati Derven, Rr. Vëllazënia nr. 5, Fushë Krujë, Shqipëri.
- b. Veprimitaria e shoqërisë kryhet në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë mund të kryhet nga degët e saj, të cilat mund të funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Administratorit të saj.
- c. Shoqëria mund të çelë degë dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato hapen dhe mbyllen me vendim të Administratorit të Përgjithshëm të Shoqërisë.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, AKSIONET, NDRYSHIMET E KAPITALIT

NENI 6

Kapitali themeltar



- a. Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.500.000 leke Ai është i ndarë, në 1 aksion me vlerë 3.500.000 leke. Aksionari i vetëm i shoqërisë zoteron aksionin e vetëm në këtë shoqëri. Aksionet e shoqërisë janë të zakonshme.
- b. Nëse përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit themeluesi i vetëm nuk ka shlyer apo kaluar tërësisht kontributet e tij në para ose natyrë, atëherë ai duhet garantojë shlyerjen e kontributit, nëpërmjet një garancie bankare, me vlerë të njëjtë ose me të madhe me kontributin e nënshkruar me afat vlefshmërie jo më shumë se njëvjeçar e t'ia paraqesë këtë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit së bashku me aplikimin për regjistrim.

NENI 7

Regjistri i Aksioneve

- a. Pronësia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarëve në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga Shoqëria, sipas mënyrës të parashikuar me ligj. Me kërkesën e aksionarit, Shoqëria lëshon një vërtetim të regjistrimit të aksioneve në pronësi të tij.
- b. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për mbajtjen e regjistrat të aksioneve sipas ligjit.

NENI 8

Zmadhimi i kapitalit themeltar

- a. Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet sipas mënyrave dhe rregullave të parashikuara në nenet 168 deri 180 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- b. Me përashtim të rastit të parashikuar në nenin 176 të ligjit të mësipërm, zmadhimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme e cila vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote apo përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.
- c. Kapitali themeltar nuk mund të zmadhohet nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë.
- d. Administratori është i detyruar të njoftojë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit.

NENI 9

Zvogëlimi i kapitalit themeltar



- a. Zvogëlimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë kryhet vetëm me Vendim të Asamblesë të Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë dhe në pajtim me dispozitat e neneve 181 deri 186 të ligjt Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- b. Zvogëlimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme e cila vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote apo përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.
- c. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve. Zvogëlimi i kapitalit themeltar nuk duhet të cënojë raportin e aksionarit para këtij zvogëlimi.
- d. Kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën shumën minimale të kërkuar nga ligji.

NENI 10

A.Të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

- a. Çdo aksion jep të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet vjetore të Shoqërisë të destinuara për shpërndarje dhe në tepricën e aktivit të mbetur në rastin e likuidimit në përpjesëtим me aksionet që zotëron. Pronësia mbi aksionet jep edhe të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme në kushtet e përcaktuara në ligj dhe në statut.
- b. Aksionarët përgjigen për detyrimet e Shoqërisë ndaj të tretëve dhe për humbjet e saj deri në masën e shumës nominale të aksioneve që zotëron. Ndalohet kërkimi i fondeve të kësaj shume.
- c. Kur aksionet u kalojnë aksionarëve të rinj, këta ruajnë të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga aksionet. Pronësia e një aksioni përmban automatikisht të drejtën e aderimit në statutin e Shoqërisë dhe në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

B.Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve

1. Aksionet e një shoqërie aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.



2. Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpala se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të ligjit tregtar.
3. Ne rastet e kalimit te aksioneve me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi aksionin, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshi momentin e pageses se cmimit, rregullohen nga kontrata.
- a. Kontrata per kalimin e aksionit hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates.
- b. Transaksionet ne forme elektronike, sipas parashikimeve te ligjit nr. 9879, date 21.2.2008, "Per titujt", konsiderohen te kryera ne forme shkresore ne perputhje me parashikimet e ketij neni. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakord ne kontrate, vlefshmeria e kalimit te titullit te pronesise mbi aksionet nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteteve te ndryshme me efekt deklarativ, perfshi ketu formalitetet e regjistrimit a publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit.
- c. Përpala cdo forme transferimi askionesh sipas parashikimeve ne këtë statut, duhet të ushtrohet e drejta e parablerjes ndaj aksionarëve të shoqërisë .
- d. Në rastin kur kërkohet të kalohet në transferimin e aksioneve jashtë shoqërisë duhet të merret vendimi i Asamblesë të Jashtëzakonshme të Shoqërisë. Procedurat e mëtejshme në lidhje me shit-blerjen e aksioneve do të përcaktohet me rregullore të veçantë të Këshillit Mbikëqyrës, e cila do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerit të Vetëm.

KAPITULLI III ORGANET E SHOQËRISË

SEKSIONII ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 11

Mbledhjet e Asamblesë dhe efektet detyruese të vendimeve

Të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimit të Shoqërisë ushtrohen nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme. Çdo Asamble e mbledhur rregullisht përfaqëson tërësinë e aksioneve të zotëruara nga aksionari.

NENI 12

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet si më poshtë të Shoqërisë:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare;



- b. Ndryshime në statut;
- c. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;
- d. Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. Miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e këshillit mbikëqyrës, administratorit, likuiduesit, ekspertët kontabël të autorizuar;
- f. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
- g. Shpérndarjen e fitimeve vjetore;
- h. Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- i. Pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- j. Ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë;
- l. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të saj;
- m. Miratimin e rregulloreve të këshillit mbikëqyrës
- n. Miratimin e krijimit të garancive me anë të pasurisë së shoqërisë;
- o. Miratimin e pjesëmarrjes në shoqëri të tjera;
- p. Miratimin e kryerjes të investimeve që nuk përfshihen në programin financiar vjetor;
- q. Të miratojë marjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
- r. Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
- s. Cështje të tjera të parashikuara në ligj dhe statut.

NENI 13

A.Mbledhja e Asamblesë

- a. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- b. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim. Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo kritikuar veprimtarinë e organeve administrative.
- c. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- d. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- e. Asambleja thirret nga Administratori, Këshilli Mbikëqyrës ose aksionarët të cilët zotërojnë aksione, të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- f. Ajo thirret të paktën një herë në vit. Asambleja mblidhet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjeter të treguar në thirrje, si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu dhe jashtë territorit, e cila tregohet në njoftimin përkatës.
- g. Thirrja e Asamblesë bëhet me anë të njoftimit me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike që i dërgohet aksionarëve së bashku me rendin e ditës, jo më vonë se 21 ditë përparrë datës së parashikuar të mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë ditën, orën dhe vendin e mbledhjes, natyrën e Asamblesë, dhe rendin e ditës.
- h. Kur Asambleja e mbledhur nuk ka mundur të marrë vendim për shkak se nuk është siguruar kuorumi i kërkuar, mbledhja e dytë thirret jo më vonë se 30 ditë nga data e thirrjes së parë në të njëjtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes së mbledhjes së dytë rikujtojnë datën dhe rendin e ditës.

B.Mënyra e thirrjes së Asamblesë

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:
 - a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
 - b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:
 - i) të drejtat e aksionarëve, sipas nenit 139 të ligjit;
 - ii) procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;
 - iii) procedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;
 - c) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 138 të ligjit;
 - ç) adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i përcaktuar në këtë nen. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
3. 21 ditë përparrë datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, përfshirë këtu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vërë në dispozicion aksionarëve në faqen e saj në internet, të paktën informacionin vijues:
 - a) informacionin sipas pikave 1 e 2 të këtij neni;
 - b) numrin total të aksioneve dhe të drejtave të votës që u përkasin këtyre aksioneve në datën e njoftimit të thirrjes së mbledhjes, përfshirë shumat totale për çdo kategori aksionesh, kur kapitali i shoqërisë ndahet në dy apo më shumë kategori aksionesh;
 - c) çdo dokument që do t'i vihet në dispozicion asamblesë së përgjithshme.



- d) Në rastin kur shoqëria aksionare ka shume (mbi 50) aksionarë, thirrja e mbledhjes së asamblesë se përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.
- e) Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.
- f) Administratorët apo anetaret të këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- g) Autorizimi jepet ne forme shkresore vetem per një mbledhje te asamblese se përgjithshme dhe eshte i vlefshem edhe per mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

C. Pjesëmarrja në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme

- a. Asambleja e përgjithshme mund të përcaktojë rregulla pér procedurat e mbajtjes dhe pjesëmarrjen në asamble. Këto rregulla miratohen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e tre të katërtave të kapitalit.
- b. Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.
- c. Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japid, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.
- d. Aksionarët, nëpërmjet një marrëveshjeje unanime me shkrim, mund të vendosin që çdo vendim, që ata kanë të drejtë të marrin sipas këtij ligji apo statutit të shoqërisë, të merret në mënyrë unanime.

NENI 14

Rendi i ditës

- a. Rendi i ditës së mbledhjes së Asamblesë që njoftohet si më sipër, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara pér çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë pér ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.
- b. Administratori duhet t'i përgjigjet me shkrim, çdo kërkesë me shkrim pér sqarim pér rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- c. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formalitetave si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord pér të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 15

Procesverbalet e mbledhjeve të asamblesë



- a. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të registrohen në procesverbal. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.
- b. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënrat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalist, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarjen, si dhe të aksionarëve, që janë shprehur kundër.
- c. Procesverbalist i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- d. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalist.
- e. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, administratorët janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalist të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë.
- f. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve dhe vendimeve të marra nga Asambleja.

NENI 16

Kuorumi

- a. Për çështjet që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja merr vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarë që zoterojnë më shumë se 50% të aksioneve, me të drejtë vote. Për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse aksionarët që zoterojnë $\frac{3}{4}$ e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete të tjera elektronike.
- b. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të kerkuar, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

NENI 17

Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë. Për çështjet e tjera Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicën e thjeshte te votave të aksionarëve që marrin pjesë.

NENI 18

Mënyra e votimit



Asambleja e Përgjithshme si rregull i merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur. Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës apo Administratorit Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë kërkohet nga aksionarët që zoterojnë një numër aksionesh që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

NENI 19

Vënia në dispozicion të Aksionarit të dokumenteve dhe informacioneve

Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të Aksionarit, në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogaritë vjetore që shqyrton Asambleja. Me përjashtim të inventarëve dhe të ndonjë dokumenti tjetër të caktuar nga Asambleja, dokumentet që duhet t'u vihen në dispozicion Aksionarit u dërgohen këtij bashkë me njoftim-thirrjen përmblledhje.

SEKSIONI 2

KËSHILLI MBIKËQYRËS

NENI 20

A. Përbërja dhe emërimi

- a. Këshilli Mbikëqyrës kryen funksion mbikëqyrës përmes gjithë veprimtarinë e Shoqërisë.
- b. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë, të cilët nuk mund të janë dhe Administratorë të Shoqërisë. Ata zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë.
- c. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë 3 (tre) në numër, si më poshtë vijon:
 1. Znj. Minire Rexhaj, e Bija e Nezirit, e datëlindjes 19 qershori 1979, lindur në Suharekë, Kosovë dhe banues në Kosovë, person madhor e me zotësi të plotë përmes vepruar, mbajtës i Leternjofitimit me nr. Personal. 1030519295.
 2. Z. Arianit Kabashi, i biri i Lulëzim, i datëlindjes 30 tetor 1986, lindur në Prizren dhe banues në Prizren, person madhor e me zotësi të plotë përmes vepruar, mbajtës i Leternjofitimit me nr. Personal 15000863923.
 3. Z. Fadil Rexhaj, i biri i Muarremit, i datëlindjes 15 Mars 1975, lindur në Korishë dhe banues në Kosove, person madhor e me zotësi të plotë përmes vepruar, mbajtës i Pasaportës me nr. C86W3ZNJ

të cilët kanë pranuar detyrën përmes mandatin e cakuar.



- d. Këshilli Mbikëqyrës, nga përbërja e tij ka një kryetar dhe dy anëtar që ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit. Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjatë tërë periudhës së mandatit të dhënë.

NENI 21

Mbledhjet dhe Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës

- Këshilli Mbikëqyrës mund të përcaktojë rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e Këshillit për këto rregullore duhet të janë unanime. Në hartimin e rregulloreve mbahen parasysh dispozitat ligjore dhe të këtij statuti.
- Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit regjistrohet në një procesverbal, i cili duhet të nënshkruhet nga Kryetari. Prosesverbalit përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.
- Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës vlerësohen si të vlefshme nëse në procesin e vendimmarjeve janë të pranishëm më shumë se dy të tretat e anëtarëve. Vendimet merren me unanimitet të anëtarëve të pranishëm.
- Vendimet e Këshillit të Mbikëqyrjes mund të merren sipas përcaktiveve të rregullorete të Këshillit duke shprehur votën me shkresë, telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik që bëjnë të mundur identifikimin e anëtarit.
- Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës, nëse Këshilli Mbikëqyrës duhet të marrë vendim për:
 - vlerësimin e veprimitarës së tij ;
 - faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;
 - dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

NENI 22

Kohëzgjatja e funksioneve të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

- Kohëzgjatja e anëtarëve të parë të Këshillit Mbikëqyrës është tre vjet, me të drejtë rizgjedhje.
- Ata mund të largohen nga detyra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me shumicë të thjeshtë votash.
- Ata mund të largohen nga shoqëria duke dhënë dorëheqjen, por duhet të qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen nga asambleja e anëtarit të ri dhe emërimin e tij në detyrë.

NENI 23



Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës të shkarkojë një anëtar në rastet e shkeljes së detyrave të parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të ligjt Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 24

Shpërblimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të përfitojnë pagë bazë ose shpërblime shtesë, përfshirë këtu dhe pjesë nga fitimi i Shoqërisë apo të drejta opzioni mbi aksionet e Shoqërisë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 25

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës.

Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

1. Të përgatisë me kërkësë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave që janë kompetencë e kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë;
2. Të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standartet e kontabilitetit;
3. Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë;
4. Të shqyrtojë dhe të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë;
5. Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjt apo statutit, kryhen me saktësi nga Administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'ju paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës për miratim dhe një pëershkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit finanziar;
6. Të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistimeve kontabël kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e rapporti i auditimit, drejtar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Raporti i Këshillit Mbikëqyrës të përmendur në pikën më sipër, duhet të përmbarë dhe mendimin për reportin e auditimit;
7. Të emërojë dhe të shkarkojë Administratorin, si dhe të përcaktojë kompetencat e tij shtesë, përvèc atyre që i ka dhënë ligji.
8. Të miratojë kalimin e aksioneve me propozim të Administratorit të Shoqërisë;

9. Të kryejë veprimet e tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
10. Këshilli Mbikëqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblenë e Përgjithshme në rastet si më poshtë:

- Kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e Shoqërisë nuk mbulojnë detyrime që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.
- Kur Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Kur brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejnë nga një aksionar pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë.

NENI 26

Person Juridik anëtar i Këshillit Mbikëqyrës

Një person juridik që është aksionar i Shoqërisë nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës. Ata janë individë të cilët duhet të janë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratori i Shoqërisë.

SEKSIONI III *ADMINISTRIMI*


Neni 27 Administratori

Administratori drejton dhe administron shoqërinë dhe merr vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare.

Shoqëria ka një Administrator, i cili është Z. Fatmir Rexhaj, i biri i Muharremit, lindur në Prizren, më 4 Prill 1973, banues në Korishe-Prizren, Kosovë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID me Nr. Personal' 1003215683.

Specimeni i firmës _____

Neni 28 Emërimi dhe shkarkimi

- 
- a) Administrator i shoqërisë është person fizik. Ai emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës për një afat prej 3 vitesh. Ai mund të rizgjidhet.
 - b) Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit mbikëqyrës të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.

- c) Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të shkarkojë administratorët në çdo kohë.

Neni 29

Te drejtat dhe përgjegjësitë

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b. Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare me te tretet;
- c. Të marrë vendim për hapjen dhe mbylljen e adresave dytësore dhe ti rrgjistrojë ato pranë QKB.
- d. Të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët pa miratimin e asamblese deri vleren 2.500.000,00 leke ose ekivalentin ne EURO.
- e. Te mos marre vendime individuale per marjen e kredive bankare, pa miratimin e Asamblese;
- f. Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
- g. Të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit mbikëqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për tu paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
- h. Të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rr Ethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- i. Të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
- j. Të raportojnë përpara këshillit mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
- k. Të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
- l. Administratori duhet të informojë menjëherë kryetarin e këshillit mbikëqyrës në rastet kur:
 1. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton apo parashikohet se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% të kapitalit ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.
 2. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



3. brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozohet blerja nga një aksionar e pasurisë që ka vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë,

Neni 30

Përfaqësimi i shoqërisë

- Administratori përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretët. Në rastin e disa administratorëve të cilët kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë tregtare në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara.
- Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 31

Detyrime tjera dhe përgjegjësi Administratorit

- Të kryejë detyrat e tyre në mirëbesim e në interesin e shoqërisë;
- Të ushtrojë kompetencat që u jep ligji dhe statuti;
- Të vlerësojë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;
- Të ushtrojë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

Ai përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ai përgjigjet në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimitarisë së shoqërisë.

KAPITULLI IV EKSPERTËT KONTABËL

Neni 34

Emërimi dhe shpërblimi

- Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën për të caktuar një ose disa ekspertë kontabël të zgjedhur nga listat e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Asambleja mund të delegojë me vendim Administratorin e shoqërisë për të caktuar ekspertin kontabël dhe për të nënshkruar kontratën për shërbimet që do të kryejë.



- b. Në caktimin e ekspertëve mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara në rregullat e posaçme. Ekspertët kontabël caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.
- c. Shpërblimi i ekspertëve kontabël të autorizuar caktohet nga administratori, i cili ka të drejtë te nenshkruaje kontraten perkatese, periodike.
- d. Shoqëria do të ketë ekspert kontabël **Z.Nikolla GECO**, Ekspert Kontabel i Regjistruar i licensuar nga I.E.K.A. me Nr. 64 date 10.02.2000, NIPT : K91316036S.

Neni 35

Detyrat dhe të drejtat

- a. Detyrat dhe të drejtat
- b. e ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga legislacioni shqiptar në fuqi
- c. Asambleja e përgjithshme mund t'u kërkojë ekspertëve kontabël të autorizuar kryerjen e kontolleve apo verifikimeve të posaçme për çështje me interes të shoqërisë. Me marrjen e raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqërisë. Raportet që ata përgatitin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI V LLOGARITË VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT

Neni 36

Viti finanziar

Shoqëria përgatit çdo vit finanziar llogaritë vjetore në pajtim me ligjin për kontabilitetin. Viti finanziar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 37

Caktimi i rezultateve

Rezultati i vitis finanziar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mbas dhënies së raportit përfundimtar nga ekspertët kontabël të autorizuar.

Neni 38

Fitimet dhe fondi rezervës



- a. Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen sipas një vendimi përkatës së Asamblesë ndërmjet aksionerëve pasi të jenë zbritur nga kjo shumë taksat dhe tatimet sipas ligjit, vlera e humbjeve të pësuara gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5 % (pesë për qind) që destinohet përfondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur nivelin maksimal prej 1/10 e kapitalit themeltar.
- b. Aksionerët mund të vodosin sipas ligjit përfundimin e fitimit të pashpérndarë. Me vendimin e miratimit të bilancit ushtrimor, Asamblea e Përgjithshme mund të vodosë t'i destinojë fitimet që i takojnë ortakëve në formë dividendi përfundim të kapitalit themeltar, investime ose mbartje, etj.

KAPITULLI VI PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 39
Prishja, likuidimi

A. Shoqeria aksionare prishet:

- a) kur mbaron kohezgjatja, per te cilen eshte themeluar;
- b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
- c) ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfunkcionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimitarise tregtare;
- c) ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise, te parashikuara nga neni 3/1 te ligjit;
- d) kur, si pasoje e humbjeve ushtrimore, kapitalet e veta te shoqerise jane ne vlore me te ulet se vlera minimale e kapitalit te regjistruar, te percaktuar sipas nenit 107, te ligjit, apo kur vendoset zvogelimi i kapitalit te regjistruar te shoqerise nen kete vlore minimale dhe hyrja ne fuqi e ketij zvogelimi nuk kushtezohet me realizimin e nje zmadhimi vijues, nepermjet te cilit shoqeria te rikapitalizohet me kontribute te reja me vlore, te pakten, sa vlera e nevojshme per te arritur kapitalin minimal te percaktuar sipas atij neni;
- dh) ne raste te tjera, te parashikuara ne statut;
- e) ne raste te tjera, te parashikuara me ligj;
- e) per cdo shkak tjeter te vodosur nga asambleja e aksionareve.

2. Prishja e shoqerise si pasoje e nje apo me shume prej shkaqeve te percaktuara ne perputhje me shkronjat "a", "c", "d", "dh", "e" dhe "e", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga asambleja e aksionareve me shumicen e parashikuar sipas pikes 1, te nenit 145, te ligjit.



3. Ne rast mosveprimi te asamblese se aksionareve per te vendosur prishjen, sipas rasteve te parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", te pikes 1, te ketij neni, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, ne cdo kohe, per te konstatuar prishjen e shoqerise.
4. Pavaresisht nga parashikimet e siperper-mendura, ekzistanca e nje a me shume shkaqeve te parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", te pikes 1, te ketij neni, nuk do te kete si pasoje prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nese perpara vendimit gjyqesor te formes se prere, te permendor ne piken 3, te ketij neni, shkaku i prishjes eshte korriguar, nese eshte e mundshme te korrigohet, dhe ky korrigim eshte publikuar nga shoqeria ne regjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjt nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.
5. Prishja e shoqerise, si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "b", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentimit, kur, ne perfundim te ketyre procedurave, te gjitha pasurite e shoqerise jane likuiduar per shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditoreve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendo rrezimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se shoqerise per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.
6. Prishja e shoqerise, si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "c", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve te nenit 3/1 te ligjt tregtar.

B.LIKUJDIMI

- Likuidimi i zakonshëm kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Në rast se asambleja nuk merr vendim për caktimin e likuiduesit ai zgjidhet nga gjykata.
- Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve.
- Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.
- Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së ketyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.
- Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpérndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetur, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.
- Pas shpérndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjëstrimin e shoqërisë.

- g. Për sa i përket likuidimit të thjeshtëzuar ky mund të kryhet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.
- h. Administratorët njoftojnë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar, gjithashtu ata janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtë.

Neni 40

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj që lindin midis shoqërisë dhe Aksionarit, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksonit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

KAPITULLI VII

DISPOZITA TË FUNDIT.

NENI 41

Nëpunësit, të zgjedhurit nga Organet drejtuese të shoqërisë, e personat që punojnë për llogari të saj, mbajnë përgjegjësi penale e civile sipas ligjit përkatës kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara e i shkaktojnë humbje Shoqërisë.

NENI 42

- a. Statuti hyn në fuqi me regjistrimi e tij në Registrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- b. Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në veçanti ligji nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar në fuqi.

NENI 43

Statuti i Shoqërisë pasi u lexua nga Aksionari i Vetëm i Shoqërisë u nënshkrua prej tij pa vërejtje.

AKSIONARI I VETËM

Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë

